

PROGRAMI PËR VLERËSIMIN E ARRITJEVE TË NXËNËSVE ME QËLLIM IDENTIFIKIMIN E NEVOJAVE PËR PËRMIRËSIM

KLASA VI

Gjuhë shqipe
Matematikë
Gjuhë e huaj

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	1
HYRJE.....	2
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE	4
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS.....	8
REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	13

HYRJE

Institucionet arsimore në të gjithë botën janë duke u përballur me sfidat që solli pandemia COVID-19. I njëjti realitet është edhe në shkollat tona. Për të parandaluar përhapjen e virusit dhe për të siguruar shëndetin e mësuesve dhe të nxënësve, shkollat e realizojnë procesin mësimor mbi bazën e orientimeve të dhëna në Udhëzuesin për fillimin e vitit shkollor 2020-2021. Në këtë udhëzues parashikohen tre skenarë për zhvillimin e procesit mësimor:

- 📖 mësim në shkollë;
- 📖 mësim i kombinuar (në shtëpi dhe në shkollë);
- 📖 mësim në kushtet e shtëpisë (online).

Këta skenarë janë zbatuar nga shkollat në varësi të infrastrukturës së tyre, të numrit të nxënësve dhe të situatës epidemiologjike. Mësimi në distancë ose i kombinuar ka bërë të mundur që pjesa më e madhe e nxënësve të vijojë normalisht me ndërtimin e njohurive dhe të aftësive lëndore, megjithatë ka pasur nxënës që për arsye të ndryshme (kanë kaluar COVID-19, nuk kanë pasur gjithmonë qasje në internet, nuk ka qenë gjithmonë e mundur ndihma e prindërve, kanë nevojë për mbështetjen e mësuesit etj.), kanë pasur vështirësi në këtë proces.

Për të identifikuar vështirësitë dhe nevojat e nxënësve do të realizohen disa testime vjetore në lëndët kryesore. Këto teste janë *diagnostikuese*, nuk vlerësohen me notë dhe kanë për qëllim vetëm identifikimin e nevojave të nxënësve në lidhje me njohuritë dhe aftësitë kryesore të programeve mësimore.

Në klasën e gjashtë do të zhvillohen dy teste:

- Gjuhë shqipe dhe Matematikë (ky test do të jetë i përbashkët për të dyja lëndët)
- Gjuhë e huaj

Për të orientuar hartuesit e testeve, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave është hartuar programi për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në lëndët “Gjuhë shqipe”, “Matematikë” dhe “Gjuhë e huaj”. Këto lëndë zhvillojnë te nxënësit kompetencat më të rëndësishme, të cilat janë jo vetëm kusht për nxënien e të gjitha lëndëve në shkollë, por edhe për suksesin në jetë dhe në tregun e punës. Hartimi i këtij programi është mbështetur në programet e gjuhës shqipe, të matematikës dhe të gjuhës së huaj për klasën e gjashtë dhe përfshin njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit.

Programi ka tri pjesë:

1. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës shqipe
2. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e matematikës
3. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave në lëndën e gjuhës së huaj

Përdoruesit e programit janë:

- specialistët e vlerësimit në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), të cilët do të bazohen në këtë program për hartimin e testit;
- mësuesit, të cilët do t'i përdorin rezultatet e testit për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe për planifikimin e punës në lidhje me përmirësimin e arritjeve;
- drejtuesit e shkollave, të cilët do të koordinojnë dhe do të monitorojnë procesin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe përmirësimin e tyre.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	
<p>Tekste letrare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekste poetike - Tekste në prozë - Renditja e ngjarjeve në një tekst - Analiza e personazheve - Dallimet kryesore mes teksteve letrare dhe jo letrare - Metafora, personifikimi 	<p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon tekste të ndryshme letrare (poetike dhe në prozë), të përshtatshme për moshën e tij; - tregon brendinë ose përmbajtjen e tekstit; - u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij ose me shembuj nga teksti; - rendit ngjarjet e një teksti sipas rendit kronologjik; - përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet; - analizon pamjen e jashtme, tiparet dhe sjelljen e personazheve (duke u bazuar në tekst); - analizon marrëdhëniet mes personazheve dhe i krahason me veten ose me njerëzit që njeh; - gjen në një tekst idetë kryesore dhe temën; - jep dhe argumenton këndvështrimet e tij rreth temës, ideve, personazheve etj.; - kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato; - dallon personifikimin dhe metaforën, si dhe tregon efektin që krijojnë ata;
Tekste jo	Të lexuarit e teksteve jo letrare

letrare

- Intervista
- Udhëzime të thjeshta
- Artikuj gazetash dhe revistash
- Tiparet kryesore të teksteve jo letrare
- Funkzioni i tabelave, pikturave, ilustrimeve etj., që shoqërojnë tekstet.

Nxënësi:

- lexon tekste, si: intervista, udhëzime, artikuj gazetash dhe revistash etj.;
- dallon karakteristikat e përbashkëta të teksteve si: tema, paragrafi, fjalitë përmblylëse, fjalori etj.;
- pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore (nga tekstet që lexon) dhe i përdor ato;
- dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst;
- dallon në një tekst përdorimin e argumenteve pro dhe kundër për një çështje të caktuar;
- shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve, me të cilat shoqërohen tekstet.

Kompetenca: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

Procesi i të shkruarit

Nxënësi:

- identifikon qëllimin e tij kur shkruan një tekst;
- zgjedh formën e duhur të detyrës me shkrim në varësi të qëllimit që ka;
- mbështet mesazhin kryesor të një teksti me detaje përshkruese, me fakte ose me shembuj të ndryshëm;
- respekton strukturën e punës me shkrim (hyrje, zhvillim, mbyllje);
- përdor gjatë të shkruarit gjuhën standarde dhe respekton rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore;

	<ul style="list-style-type: none"> - bën ndryshime në punën me shkrim për të përmirësuar përmbajtjen dhe qartësinë e tekstit, si dhe drejtshkrimin.
Të shkruarit për qëllime personale <ul style="list-style-type: none"> - Rrëfime përvojash ose ngjarjesh të jetuara që janë të rëndësishme në jetën e nxënësit. - Shkrimi i një tregimi të shkurtër. - Përshkrime me imagjinatë të figurave dhe personazheve të ndryshme. 	Të shkruarit për qëllime personale <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: fabul, personazh, dialog, mjedis, kohë; - rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tyre; - krahason dy ose më shumë personazhe, ngjarje, mjedise etj.
Të shkruarit për qëllime funksionale <ul style="list-style-type: none"> - Udhëzime të thjeshta - Letra - Ftesa 	Të shkruarit për qëllime funksionale <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan udhëzime të shkurtra; - shkruan letra duke respektuar strukturën e tyre; - shkruan një ftesë për një festë ose për një ngjarje të shënuar.
Kompetenca: Përdorimi i drejtë i gjuhës	

<p>Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. - Përcaktori, llojet e tij. - Ndajshtimi si një lloj përcaktori. 	<p>Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton në fjali kryefjalën; - dallon përshtatjen e kryefjalës me kallëzuesin; - përcakton në fjali kallëzuesin; - gjen llojet e përcaktorit dhe mënyrat e shprehjes së tij; - argumenton pse një gjymtyrë është përcaktor; - dallon dhe përdor ndajshtimin.
<p>Morfologji</p> <ul style="list-style-type: none"> - Klasat e fjalëve. - <i>Emri</i>: Emri dhe kategoritë e tij gramatikore. - <i>Foljet</i>: Zgjedhimi i foljeve në mënyrën dëftore dhe kohët e saj. Zgjedhimi i foljeve në mënyrën lidhore dhe kohët e saj. - <i>Përemri</i>: Llojet e përemrave. 	<p>Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton klasat e fjalëve; - analizon emrin në kategoritë e tij gramatikore: gjini, numër, rasë dhe shquarsi-pashquarsi; - përcakton zgjedhimin e foljes; - zgjedhon foljet në mënyrën dëftore dhe lidhore - dallon dhe përcakton llojin e përemrave.
<p>Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>e</i> në pozicione të ndryshme. - Drejtshkrimi i fjalëve që e kanë zanoren <i>ë</i> në pozicione të ndryshme. 	<p>Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shkruan drejt fjalët që e kanë zanoren <i>e</i> në pozicione të ndryshme; - shkruan drejt fjalët që e kanë zanoren <i>ë</i> në pozicione të ndryshme.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E MATEMATIKËS

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Tematika: Numri	
Numrat natyrorë <ul style="list-style-type: none"> - Faktorët për numrat dyshifrorë. - Shumëfishi i përbashkët i dy numrave. 	Numrat natyrorë <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - gjen shumëfishat e përbashkët të dy numrave (p.sh., i 4 dhe 5).
Thyesat <ul style="list-style-type: none"> - Kthimi i thyesave në numra të përzier dhe anasjellas. - Krahasimi i thyesave me emërues të njëjtë dhe të ndryshëm. 	Thyesat <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kthen thyesat në numra të përzier dhe anasjellas; - gjen emëruesin e përbashkët të dy thyesave; - krahason thyesat me emërues të njëjtë dhe të ndryshëm.
Numrat dhjetor <ul style="list-style-type: none"> - Krahasimi dhe renditja e numrave dhjetorë, me jo më shumë se dy shifra pas presjes. - Rrumbullakimi i numrit dhjetor në dhjetëshen më të afërt dhe numrin e plotë më të afërt. - Kthimi i numrave dhjetorë dhe thyesa dhe anasjellas (duke përdorur pjesëtimin). 	Numrat dhjetorë <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krahason dhe rendit numrat dhjetorë, me jo më shumë se dy shifra pas presjes; - demonstroi rrumbullakimin e numrit dhjetor në dhjetëshen më të afërt dhe numrin e plotë më të afërt; - lidh konceptin e numrave dhjetorë me thyesat dhe anasjelltas.
Përqindja	Përqindja

<ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i përqindjes. - Gjetja e përqindjes së një numri në ilustrime e situata praktike. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton përqindjen si pjesë e 100 dhe e paraqet në përqindje si: 1: 2; 1: 4; 1: 5; 1:10; 1: 100 ; - identifikon përqindjen e një numri në ilustrime e situata konkrete nga jeta reale.
<p>Numrat e plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi dhe krahasimi i numrave të plotë me anë të paraqitjeve konkrete. 	<p>Numrat e plotë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kupton dhe krahason numrat e plotë me anë të paraqitjeve konkrete, kryesisht në boshtin numerik.
<p>Mbledhja dhe zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja dhe zbritja e numrave dhjetorë me të njëjtën ose jo numër shifrash në pjesën dhjetore. - Ndryshesa e numrave pozitive dhe negative në boshtin numerik, si dhe në kontekstin e gjetjes së temperaturave 	<p>Mbledhja dhe zbritja</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mbledh dhe zbret numrat dhjetorë me të njëjtën ose jo numër shifrash në pjesën dhjetore (p.sh., $3.76 + 5.84$; $4.89 + 6.5$); - identifikon ndryshesën e numrave pozitive dhe negative në boshtin numerik dhe në kontekstin e gjetjes së temperaturave.
<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shumëzimi i dy numrave, kur njëri është numër dyshifror, shumëfish i 10 dhe tjetri është numër treshifror, shumëfish i 100. - Shumëzimi i numrave natyrorë katërshifrorë me numra njëshifrorë, si dhe i numrave dyshifrorë ose treshifrorë me numra dyshifrorë. 	<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - shumëzon dy numra dyshifrorë, shumëfisha të 10 ose një shumëfish i 10, numër dyshifrorë dhe një shumëfish i 100, numër treshifrorë (p.sh., 20×40; 40×300); - shumëzon dy numra natyrorë katërshifrorë me numra njëshifrorë dhe dy

	numra dyshifrorë ose treshifrorë me numra dyshifrorë (p.sh., 4589 x 6; 56 x 78; 156 x 23).
Tematika: Matja	
Gjatësia, masa, koha, këndet	Gjatësia, masa, koha
<ul style="list-style-type: none"> - Këmbimi i njësive të matjes (kg me g; km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në tre shifra pas presjes. - Njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe këmbimi i tyre. - Ora me sistemin 24 orësh. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - këmben njësitë e matjes (kg me g; km, m, cm, mm) me numra dhjetorë deri në tre shifra pas presjes; - zbaton njësitë e matjes së kohës (sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti, dekada, shekulli) dhe i këmben ato; - lexon dhe përdor sistemin 24 orësh; - llogarit kohën në tabelat e orareve me sistemin 24 orësh; - llogarit orën në zona të ndryshme të botës;
Perimetri dhe syprina	Perimetri dhe syprina
<ul style="list-style-type: none"> - Formula për perimetrin dhe syprinën e katrorit, e drejtkëndëshit. - Syprina e një figure thjeshtë të përbërë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njehson perimetrin dhe syprinën e katrorit; - njehson perimetrin dhe syprinën e drejtkëndëshit; - llogarit syprinën e një figure të thjeshtë të përbërë.
Tematika: Gjeometria	
Gjeometria në plan	Gjeometria në plan
<ul style="list-style-type: none"> - Katërkëndëshi (rombi, paralelogrami, drejtkëndëshi, katrori, trapezi) veti të këndeve dhe brinjëve pa vërtetim. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - klasifikon shumëkëndëshat sipas vetive të tyre;

<p>Gjeometria në hapësirë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet). 	<p>Gjeometria në hapësirë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përcakton elementet e trupave gjeometrikë (faqet, brinjët, kulmet).
<p>Nxënësi:</p> <p>Shndërrimet gjeometrike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i koordinatave në rrjetin koordinativ. 	<p>Shndërrime gjeometrike dhe sistemi koordinativ</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon dhe plotëson koordinatat në rrjetin koordinativ.
<p>Tematika: Algjebra dhe funksioni</p>	
<p>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</p> <ul style="list-style-type: none"> - Numri që mungon në një shprehje numerike me numra natyrorë, numra dhjetorë, thyesa ose të kombinuara. 	<p>Ekuacione, inekuacione, sisteme të ekuacioneve</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon numrin që mungon në një shprehje numerike me numra natyrorë ose numra dhjetorë ose thyesa ose të kombinuara.
<p>Funksioni</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vargje numerike (me kufiza numra natyrorë ose dhjetorë), në përshtatje me njohuritë për veprimet me numra natyrorë e dhjetorë. 	<p>Funksioni</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe vazhdon një varg numerik (me kufiza numra natyrorë ose dhjetorë ose thyesa), në përshtatje me njohuritë për veprimet me numra natyrorë, dhjetorë ose thyesa.
<p>Tematika: Statistika dhe probabiliteti</p>	

Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave

- Interpretimi i tabelave dhe diagrameve të gatshme.
- Moda, mesorja dhe mesatarja aritmetike për një grup të dhënash.

Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave

Nxënësi:

- interpreton të dhëna të thjeshta, të gatshme, të marra nga grafikë të jetës reale;
- gjen mesataren aritmetike, modën, mesoren për një grup të dhënash.

Probabiliteti

- Përdorimi i shprehjeve: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase, me siguri dhe i të tjerave të ngjashme me to.

Probabiliteti

Nxënësi:

- përdor shprehjet: ka mundësi, nuk ka mundësi, mbase, me siguri dhe i të tjerave të ngjashme me to, në situata të jetës reale.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ

Njohuritë	Rezultatet e të nxënit
Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar	
<p>Përshkrimi:</p>	
<p>Nxënësi kupton tekste të shkurtër dhe të thjeshtë të hartuar kryesisht në një gjuhë të përditshme dhe me fjalor të një frekuence të lartë.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Interesat personale - Jeta e përditshme - Ushqimi, sportet, veshjet - Profesionet - Koha e lirë - Programet televizive 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lexon dhe kupton tekste që përmbajnë fjalë dhe fraza me fjalor të njohur nga fondi bazë i gjuhës së huaj; - kupton letra personale të thjeshta; - dallon informacionin bazë dhe disa detaje në një tregim që trajton temë të njohur me fjalor përgjithësisht të trajtuar më parë; - identifikon informacionin specifik në broshura dhe artikuj të shkurtër.
Përdorimi i drejtë i gjuhës	
<p>Përshkrimi: Nxënësi përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të mësuara gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> - Emrat në numrin njëjës dhe shumës - Përemrat dëftorë - Kohët e tashme të foljeve - Parafjalët - Mbiemrat 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe formon fjali të thjeshta dëftore, pyetëse, në kohët e tashme; - zgjedhon foljet në kohët e tashme, sipas modeleve të dhëna; - përdor përemrat lidhorë; - përdor mbiemrat cilësorë, pronorë, dëftorë etj.; - dallon numrin e emrave.
Të shkruarit	


Përshkrimi: Nxënësi shkruan tekste të shkurtër dhe letra personale mbi tema të jetës së përditshme. Nxënësi përdor fjali dhe shprehje të thjeshta të lidhura me lidhëzat “dhe”, “por”, “sepse”.

- Shkrimi i mesazheve të shkurtra.
- Përshkrimi i veprimtarive dhe i rutinës.
- Shkrimi i shënimeve të shkurtra.
- Përshkrimi i shtëpisë/dhomës/shkollës.
- Shkrimi i një letre ose e-maili të shkurtër jo formal.

Nxënësi:

- shkruan një mesazh ose një letër të thjeshtë duke përdorur formula mirësjelljeje;
- përshkruan në një letër personale familjen, vendin ku banon, kohën dhe me se merret;
- përshkruan objekte, sende e kafshë të dashura për të;
- përshkruan thjeshtë një veprimtari që zhvillon në jetën e përditshme.

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**



Rruga "Naim Frashëri"
Nr. 37
Tiranë
Shqipëri

(+355) 4256440 / 4256441

sekretaria@ascap.edu.al

www.ascap.edu.al